



INSTITUTI I SHENDETIT PUBLIK

DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

PROGRAMI KOMBËTAR I VAKSINIMIT

PROCESI I VAKSINIMIT NDAJ COVID-19 DHE GRIPIT SEZONAL

JAVA 52, 2025

Permbajtja:

1. VAKSINIMI NDAJ GRIPIT SEZONAL 2025-2026 (java 52, 2025)
2. VAKSINIMI NDAJ COVID-19 (Java 43, 2024-java 52, 2025)

1. VAKSINIMI NDAJ GRIPIT SEZONAL 2025-2026

Vaksinimi ndaj gripit sezonal është një masë parandaluese për të reduktuar shtrimet në spitale, komplikacionet dhe vdekjet e shkaktuara nga viruset respiratorë sidomos tek personat me semundje bashkëshoqeruese.

Programi Kombëtar i Vaksinimit, pranë Institutit të Shëndetit Publik (ISHP) ka shpërndarë në 36 Njësi Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) **280,000 doza të vaksinës ndaj gripit sezonal**, përkatësisht:

- 40,000 doza në flakon një-dozësh
- 240,000 doza në flakon me 10 doza

Vaksinimi ndaj gripit sezonal për sezonin 2025–2026 nisi më **22 shtator 2025** në të gjithë vendin

Llojet e vaksinave të përdorura

- Gjatë këtij sezoni, në Shqipëri po aplikohen **vaksinat 4-valente** me virion te copëzuar, te inaktivizuara, GC FLU të prodhuara nga GC Biopharma në Korenë e Jugut dhe të parakualifikuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) **të cilat janë në flakone** prej 0.5ml dhe aplikohen në mënyre intramuskulare.

Grupet prioritare:

Vaksinimi ndaj gripit rekomandohet për cdo person mbi 6 muaj por grupet prioritare në Shqipëri, me rrezik më të lartë janë si më poshtë:

- Punonjësit shëndetësorë (mjekë, infermierë, staf mbështetës)
- Personat dhe stafi i institucioneve të kujdesit afatgjatë
- Personat me sëmundje kronike (kardiovaskulare, pulmonare, diabet, astmë, sëmundje të mëlçisë ose veshkave si dhe semundje te gjakut etj.)
- Persona me kancer, limfoma etj,
- Persona obezë
- Personat me imunitet të kompromentuar si personat me HIV.
- Gra shtatzëna
- Persona mbi 65 vjeç

- Fëmijët mbi 6 muaj deri 12 vjec, sidomos ata me sëmundje bashkëshoqëruese.
- Mësuesët, edukatorët, policët dhe forcat e rendit.


Ecuria e vaksinimit:

Aplikimi dhe regjistrimi në SIV i vaksinave ndaj gripit sezonal filloi më **22 shtator 2025**.

- Deri në **javën 52-të/2025 (22 Shtator – 28 Dhjetor)** janë kryer gjithsej **237 754 doza**, që përbëjnë **85 % të dozave të shpërndara**.
- NJVKSH-të me përdorim mbi 90% të vaksinave në të gjithë vendin janë **NJVKSH Skrapar (100 %), NJVKSH Gramsh (99.8 %), NJVKSH Fier (99.8 %), NJVKSH Has (99.3 %), NJVKSH Lezhë (98 %), NJVKSH Mirditë (97.8%), NJVKSH Kuçovë (97.3 %), NJVKSH Kukës (97.3 %), NJVKSH Mallakastër (97.1 %), NJVKSH Devoll (95.6 %), NJVKSH Korçë (95.6 %), NJVKSH Dibër (94.6 %), NJVKSH M.Madhe (94.1 %), NJVKSH Berat (93.1 %), NJVKSH Pogradec (92 %), NJVKSH Kolonjë (91.5%) dhe NJVKSH Tropojë 91%**
- Grupmosha **mbi 80 vjeç** është me mbulesën më të lartë vaksinale (**31.4 %**).
- Personat mbi 60 vjeç kanë një mbulesë vaksinale (**24.4 %**) dhe kanë aplikuar në total **169 293** vaksina. NJVKSH-ja me numrin më të madh të aplikimeve të vaksinës tek personat mbi 60 vjeç është **NJVKSH Tiranë** me **23 245** vaksina.
- Në grupet e riskut personat me **sëmundje kardiovaskulare** kanë mbulesën më të lartë vaksinale (**38.8 %**).
- Personat diabetikë kanë një mbulesë vaksinale (**29.2 %**) dhe në total janë aplikuar **29 213** vaksina. NJVKSH-të me numrin më të madh të aplikimeve të vaksinës tek personat diabetikë janë **NJVKSH Tiranë** me **4 074** vaksina.
- Mbulesa vaksinale e personelit shëndetësor është (**51.6 %**). Mjekë të vaksinuar janë 2 380, infermierë 9 572 dhe staf mbeshtetes jane vaksinuar 2 502. **NJVKSH-ja me numrin më të madh të aplikimeve të vaksinës tek personeli shëndetësor është NJVKSH Tiranë me 1 757 vaksina.**
- Mësuesit kanë përdorimin të mire të vaksinës, **2 161** vaksina të aplikuar.

Vlen të theksohet që NJVKSH Tiranë ka mbulim më të mirë sepse ka numrin më të madh të popullsisë dhe personelit në çdo kategori.


Ecuria e vaksinimit ndaj gripit sezonal sipas javëve paraqitet në grafikun e mëposhtëm: Java 39 paraqet kulmin e vaksinimit me 74 450 doza, duke reflektuar fillimin e fushatës dhe interesin më të lartë nga grupet e riskut. Pas kësaj jave, nga java 40 deri në 52 vërehet një rënie graduale dhe e qëndrueshme javore të vaksinimeve, e cila përputhet me ritmin normal të fushatave sezonale: javët e para kanë fluks të lartë, ndërsa më pas volumi bie pasi pjesa më e madhe e personave që përfshihen në grupet e riskut janë vaksinuar. Në javën 52 vaksinimi vijon.



Grafiku 1: Ecuria e vaksinimit sipas javëve

Përdorimi vaksinës ndaj Gripit në nivel qarku shprehur në hartë, java 52. Harta paraqet përdorimin e vaksinës sipas 12 qarqeve, e cila varion ndjeshëm midis rajoneve. Përqindjet më të larta regjistrohen në Kukës (96.04 %), Berat (95.4 %), Korçë (94.2 %), Lezhë (93.5 %), Fier (87.3 %), Gjirokastër (84.6 %) dhe që tregojnë për një qasje të fortë ndaj vaksinimit dhe një angazhim të mirë të strukturave shëndetësore dhe komunitetit.

Qarqet me përdorim më të ulët janë Elbasani (74.4 %), Shkodra (81.1 %), Dibra (81.2 %), Durrës (81.3 %), Vlora (82 %), Tirana (82.6 %) dhe çka sugjeron nevojë për përf forcimin e fushatave informuese, mobilizimin e shërbimeve shëndetësore dhe adresimin e barrierave lokale (hezitimi dhe ndjekja aktive e grupeve të riskut).



Harta 1: Përdorimi i vaksinës ndaj Gripit në % sipas qarqeve


Shpërndarja e dozave të shperndara dhe të aplikuara sipas 36 NJVKSH-ve paraqitet në tabelën e mëposhtme. Të dhënat tregojnë se shumica e NJVKSH-ve kanë një **përdorim të mirë** në aplikimin e vaksinës ndaj gripit sezonal.

	NJVKSH	Sasia ne doza	Sasia e shperndare (GC Flu 1/doze)	Sasia e aplikuar me (GC Flu 1/doze)	% e aplikimit (GC Flu 1/doze)	Sasia e shperndare (GC Flu 10/doze)	Sasia e aplikuar me (GC Flu 10/doze)	% e aplikimit (GC Flu 10/doze)	TOTAL	% e aplikimit ne total
Shkodër	Shkodër	14000	1000	748	74.8	13000	9954	76.57	10702	76.44
	Malësi e Madhe	3500	500	382	76.4	3000	2914	97.13	3296	94.17
	Pukë	2500	500	306	61.2	2000	1934	96.70	2240	89.60
Kukës	Kukës	4000	500	487	97.4	3500	3405	97.29	3892	97.30
	Has	1500	500	490	98.0	1000	1000	100.00	1490	99.33
	Tropojë	2000	500	487	97.4	1500	1334	88.93	1821	91.05
Lezhë	Lezhë	6000	500	466	93.2	5500	5415	98.45	5881	98.02
	Mirditë	2500	500	483	96.6	2000	1962	98.10	2445	97.80
	Kurbín	4500	500	500	100.0	4000	3329	83.23	3829	85.09
Tiranë	Tiranë	36000	6000	4618	77.0	30000	25628	85.43	30246	84.02
	Kavajë	7000	1000	727	72.7	6000	4685	78.08	5412	77.31
Durrës	Durrës	17000	3000	2146	71.5	14000	11645	83.18	13791	81.12
	Krujë	6000	1000	582	58.2	5000	4333	86.66	4915	81.92
Dibër	Dibër	6000	1000	881	88.1	5000	4796	95.92	5677	94.62
	Bulqizë	3500	500	377	75.4	3000	2042	68.07	2419	69.11
	Mat	3800	800	472	59.0	3000	2231	74.37	2703	71.13
Fier	Fier	27600	2600	2553	98.2	25000	24998	99.99	27551	99.82
	Mallakastër	2900	400	400	100.0	2500	2416	96.64	2816	97.10
	Lushnjë	22000	2000	1676	83.8	20000	13811	69.06	15487	70.40
Vlorë	Vlorë	18500	1500	1451	96.7	17000	14171	83.36	15622	84.44
	Delvinë	3450	450	413	91.8	3000	1454	48.47	1867	54.12
	Sarandë	4800	800	682	85.3	4000	3625	90.63	4307	89.73
Gjirokastrë	Gjirokastrë	7500	1000	760	76.0	6500	5450	83.85	6210	82.80
	Përmet	3450	450	294	65.3	3000	2721	90.70	3015	87.39
	Tepelenë	3000	500	461	92.2	2500	2116	84.64	2577	85.90
Korçë	Korçë	11000	1000	960	96.0	10000	9553	95.53	10513	95.57
	Pogradec	6330	830	684	82.4	5500	5138	93.42	5822	91.97
	Devoll	2500	500	460	92.0	2000	1930	96.50	2390	95.60
	Kolonjë	1500	500	446	89.2	1000	927	92.70	1373	91.53
Berat	Berat	11000	1000	809	80.9	10000	9441	94.41	10250	93.18
	Kuçovë	3500	500	496	99.2	3000	2911	97.03	3407	97.34
	Skrapar	3500	500	500	100.0	3000	3000	100.00	3500	100.00
Elbasan	Elbasan	16000	4000	3544	88.6	12000	7322	61.02	10866	67.91
	Peqin	3000	500	348	69.6	2500	2081	83.24	2429	80.97
	Gramsh	3500	500	494	98.8	3000	3000	100.00	3494	99.83
	Librazhd	3500	500	314	62.8	3000	2242	74.73	2556	73.03
Total		278330	38330	31897		240000	204914		236811	85.08

Tabela 1: Sasia e dozave te shpërndara dhe përqindja e aplikimit sipas NJVKSH-ve, java 52


Ecuria e procesit te vaksinimit sipas katër rajoneve të vendit, java 52, 2025

DROSHKSH Tiranë: përfshin NJVKSH Bulqizë, Dibër, Mat, Durrës, Krujë, Tiranë dhe Kavajë. Në total janë aplikuar (82.2 %) e dozave të marra për këtë rajon ku NJVKSH-ja me përdorimin më të lartë është NJVKSH Dibër (94.6 %). Përdorimi i vaksinës në përqindje për këtë rajon paraqitet në grafikun e mëposhtëm.




Grafiku 2: Përqindja e aplikimit sipas NJVKSH-ve, DROSHKSH Tiranë

DROSHKSH Shkodër: përfshin NJVKSH Has, Kukës, Tropojë, Lezhë, Kurbin, Mirditë, Shkodër, Pukë dhe Malësi e Madhe. Në total janë aplikuar (87.8 %) e dozave të marra për këtë rajon ku NJVKSH-të me përdorimin më të lartë të vaksinës janë NJVKSH Has (99.3 %), NJVKSH Lezhë (98 %), NJVKSH Mirditë (97.8 %), NJVKSH Kukës (97.3 %), NJVKSH M. Madhe (94.2 %) dhe NJVKSH Tropojë (91.1 %).




Grafiku 3: Përqindja e aplikimit sipas NJVKSH-ve, DROSHKSH Shkodër

DROSHKSH Elbasan: përfshin NJVKSH Korçë, Pogradec, Devoll, Kolonjë, Berat, Kuçovë, Skrapar, Elbasan, Peqin, Gramsh dhe Librazhd. Në total janë aplikuar (86.6 %) e dozave të marra për këtë rajon ku NJVKSH-të me përdorimin më të lartë të vaksinës janë NJVKSH Skrapar (100 %), NJVKSH Gramsh (99.8 %), NJVKSH Kuçovë (97.3 %), NJVKSH Devoll (95.6 %), NJVKSH Korçë (95.6 %), NJVKSH Berat (93.2 %), NJVKSH Pogradec (92%) dhe NJVKSH Kolonjë (91.5 %).



Grafiku 4: Përqindja e aplikimit sipas NJVKSH-ve, DROSHKSH Elbasan


DROSHKSH Vlorë: përfshin NJVKSH Fier, Lushnjë, Mallakastër, Gjirokastrë, Përmet, Tepelenë, Delvinë, Sarandë dhe Vlorë. Në total janë aplikuar (85.2 %) e dozave të marra për këtë rajon ku NJVKSH-të me përdorimin më të lartë të vaksinës janë NJVKSH Fier (99.8 %) dhe NJVKSH Mallakastër (97.1 %).



Grafiku 5: Përqindja e aplikimit sipas NJVKSH-ve, DROSHKSH Vlorë

Mbulesa vaksinale sipas grup-moshave


Grafiku më poshtë paraqet mbulesën vaksinale sipas grupmoshave. Grupmosha me mbulesën më të lartë vaksinale është mbi 80 vjeç (31.4 %).



Grafiku 6: Mbulesa vaksinale ndaj gripit sezonal sipas grupmoshave, java 52, 2025


Aplikimi i vaksinës sipas grupeve të riskut

Grafiku paraqet administrimin e vaksinës tek personat me sëmundje kronike prioritare për tu vaksinuar ndaj gripit sezonal, ku ato me sëmundje kardiovaskulare kanë përdorimin më të lartë të saj.




Grafiku 7: Numri i vaksinave të aplikuara tek personat me sëmundje kronike, java 52, 2025


Administrimi i vaksinës sipas grupeve të riskut për të katër rajonet e vendit paraqitet në grafikët e mëposhtëm, java 52




Grafiku 8: Administrimi i vaksinës sipas grupeve të riskut, DROSHKSH Shkodër



Grafiku 9: Administrimi i vaksinës sipas grupeve të riskut, DROSHKSH Tiranë




Grafiku 10: Administrimi i vaksinës sipas grupeve të riskut, DROSHKSH Elbasan



Grafiku 11: Administrimi i vaksinës sipas grupeve të riskut, DROSHKSH Vlorë

Mbulesa vaksinale sipas grupeve të riskut


Grafiku paraqet mbulesën vaksinale sipas grupeve të riskut dhe mbulesa vaksinale më e lartë është tek personat me sëmundje kardiovaskulare. Të dhënat e popullatës me sëmundje kronike janë marrë nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH).



Grafiku 12: Mbulesa vaksinale sipas grupeve të riskut, java 52, 2025


Aplikimi i vaksinës tek personeli shëndetësor

Stafi mjekësor është ndër grupet më të ekspozuara ndaj gripit sezonal për shkak të kontaktit të vazhdueshëm me pacientët dhe ekspozimit të lartë ndaj infeksioneve respiratore. Në total në gjithë Shqipërinë në javën e 52-të/2025 janë vaksinuar 14,454 personel shëndetësor, me një mbulesë vaksinale **51.6 %**, ku infermierët përbëjnë grupin më të madh të vaksinuar me 9,572 vaksina.




Grafiku 13: Numri i vaksinave të aplikuara sipas personelit shëndetësor


Mbulesa vaksinale tek personeli shëndetësor në shërbimin parësor sipas katër rajoneve, java 52




Grafiku 14: Mbulesa vaksinale në shërbimin parësor sipas personelit shëndetësor, DROSHKSH Shkodër



Grafiku 15: Mbulesa vaksinale në shërbimin parësor sipas personelit shëndetësor, DROSHKSH Tiranë




Grafiku 16: Mbulesa vaksinale në shërbimin parësor sipas personelit shëndetësor, DROSHKSH Vlorë




Grafiku 17: Mbulesa vaksinale në shërbimin parësor sipas personelit shëndetësor, DROSHKSH Elbasan

Mbulesa vaksinale në spitalet e vendit paraqitet në grafikët e mëposhtëm (të dhënat e numrit të stafit shëndetësor në këto spitale janë marrë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale):




Grafiku 18: Mbulesa vaksinale në spitalet e vendit



Grafiku 19: Mbulesa vaksinale në spitalet e vendit sipas personelit shëndetësor

Grupet në risk prioritare për tu vaksinuar lidhur me profesionet janë shprehur në grafikun e mëposhtëm dhe numri më i madh i vaksinave është aplikuar tek mësuesit.



Grafiku 20: Numri i aplikimit të vaksinave sipas profesioneve

1. VAKSINIMI NDAJ COVID-19 (Java 43, 2024-java 52, 2025)

Në mbledhjen e datës 22 gusht 2024, Komiteti Shqiptar i Ekspertëve të Vaksinimit (NITAG) rekomandoi:

1. Vaksinimi ndaj COVID-19 duhet të vazhdojë.
2. Çdo vit duhet të aplikohet vakcina ndaj COVID-19 për grupet më prioritare dhe në rrezik.
3. Vakcina COVID-19 duhet të administrohet në të njëjtën kohë me vaksinën kundër gripit sezonal, kur është e mundur, për të shmangur që qytetarët të paraqiten dy herë në qendrat shëndetësore.
4. Të vaksinohen me një dozë të vaksinës monovalente, pavarësisht nga statusi i mëparshëm i vaksinimit, personat në grupet e mëposhtme:
 - Punonjësit shëndetësorë dhe ata që punojnë në institucione të kujdesit afatgjatë.
 - Personat që jetojnë në institucione të kujdesit afatgjatë (mbi 12 vjeç).
 - Të gjithë personat mbi 60 vjeç.
 - Personat mbi 12 vjeç me sëmundje bashkëshoqëruese, përfshirë:

- Sëmundje kardiovaskulare.
- Diabet.
- Sëmundje obstruktive të mushkërive.
- Sëmundje kronike të veshkave dhe mëlçisë.
- Lloje të ndryshme kanceri.
- Gjendje që shkaktojnë frenim të imunitetit.
- Obezitet.
- Gratë shtatzëna.

Vaksina COMIRNATY™ e Disponueshme në Shqipëri:

Aktualisht në Shqipëri është e disponueshme vakcina COMIRNATY™ Monovalent [Omicron JN.1]

COMIRNATY™ Monovalent [Omicron JN.1]


- **Përmbajtje aktive:** *bretovameran* (mRNA për nënvariantin Omicron JN.1)
- **Përdorimi:** 30 mikrogramë për adoleshentë dhe të rritur ≥ 12 vjeç
- **Data e skadencës së dozave të ardhura:** 31 mars 2026
- **Sasia e ardhur më 17 prill 2025:** 5,760 doza

Dokumentimi i Vaksinimit

Çdo vaksinë e administruar regjistrohet **në kohë reale në Sistemin e Informimit të Vaksinimit (SIV)** dhe është e disponueshme për qytetarët në **portalin e-Albania**, te seksioni “**Kartela ime e Vaksinimit**”.


Kartela ofrohet në **shqip dhe anglisht** dhe është e vlefshme për përdorim personal apo zyrtar.

Nga fillimi i përdorimit në javën e 43-të të vitit 2024 deri në javën e 52-të të vitit 2025, në Shqipëri janë administruar gjithsej **1,663 doza**.



Grafiku 1. Numri i vaksinave ndaj COVID-19 te aplikuara sipas javeve, (java 43, 2024-java 52, 2025)


Grafiku paraqet numrin e vaksinave COVID-19 të aplikuara sipas javëve, për periudhën 2024–2025. Megjithëse rekomandohet aplikimi i vaksinës kundër COVID-19, vihet re një ulje e kërkesës nga qytetarët dhe, si pasojë, edhe e numrit të vaksinave të administruara.



Grafiku 2. Numri i vaksinave ndaj COVID-19 te aplikuara sipas NJVKSH-ve (java 43, 2024-java 52, 2025)

Sic shihet në grafik **Tirana** ka numrin më të lartë të vaksinave (526), ndjekur nga **Fieri** (191) dhe **Vlora** (142).


Stafi mjekësor përbën një nga grupet me risk të lartë për ekspozim ndaj infeksionit me COVID-19, për shkak të kontaktit të drejtpërdrejtë me pacientët dhe mjediset shëndetësore. Vaksinimi i këtij grupi është thelbësor jo vetëm për mbrojtjen e shëndetit të tyre personal, por edhe për të garantuar sigurinë e pacientëve dhe vazhdimësinë e shërbimeve shëndetësore. Megjithatë, të dhënat tregojnë se përdorimi i vaksinës në këtë kategori mbetet i ulët. Ne total janë aplikuar **79 doza** deri javen e 52, 2025.



Grafiku 3: Numri i stafit mjeksor të vaksinuar ndaj COVID-19, (java 43, 2024-java 52 2025)

Infermierët kanë numrin më të madh të vaksinimeve (46), ndjekur nga **mjekët** me (24). **Stafi mbështetës** ka marrë **9 doza**. **Totali i përgjithshëm është 79**, duke reflektuar numrin e përgjithshëm të vaksinimeve në këtë kategori profesionale.


Grupet në rrezik për komplikacione të rënda nga COVID-19 përfshijnë të moshuarit, personat me sëmundje kronike (si diabet, hipertension, sëmundje kardiovaskulare, respiratore, renale dhe hepatike), individët me imunitet të kompromentuar, gratë shtatzëna, si dhe punonjësit shëndetësorë. Vaksinimi i këtyre grupeve është një masë thelbësore parandaluese për të reduktuar shtrimet në spitale, format e rënda të sëmundjes dhe rrezikun e vdekshmërisë. Për më tepër, mbrojtja e këtyre kategorive ka ndikim të drejtpërdrejtë në ruajtjen e kapaciteteve të sistemit shëndetësor dhe në sigurimin e funksionimit normal të shërbimeve të tjera mjekësore. Rekomandimet ndërkombëtare dhe ato kombëtare theksojnë rëndësinë e vaksinimit periodik për këto grupe, duke pasur parasysh se imuniteti i fituar nga vaksina apo infeksioni i mëparshëm zbehet me kalimin e kohës.



Grafiku 1: Numri I personave te vaksinuar ndaj COVID-19 sipas grupeve te riskut, (java 43, 2024-java 52, 2025)

Vaksinimi ndaj COVID-19 sipas grupmoshave

Vaksinimi kundër COVID-19 mbetet një ndër masat kryesore për parandalimin e formave të rënda të sëmundjes dhe uljen e numrit të shtrimeve në spitale. Efektiviteti dhe rëndësia e vaksinimit ndryshon sipas grupmoshave, duke reflektuar nivelin e rrezikut që secila kategori paraqet. Grupmosha **25–39 vjeç** ka numrin më të lartë të vaksinimeve (465 raste). Pas saj renditen grupmoshat **50–59 vjeç (320 raste)** dhe **60–69 vjeç (310 raste)**. Grupmoshat më të reja (12–17 vjeç) dhe më të moshuarit mbi 80 vjeç kanë numrat më të ulët të vaksinimit.



Grafiku 2: Numri i vaksinave ndaj COVID-19 te aplikuara sipas grup-moshave, (java 43, 2024-java 52, 2025)

INSTITUTI I
SHËNDETIT PUBLIK